

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I**  
**SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“INTERMED HEALTHCARE” sh.p.k.**

Themeluesi qe nenshkruan me poshte eshte si vijon:

**Z. Cem Bagdatli**, i datelindjes 04.02.1970, atesia Mahmut Enver, amesia Senel, lindur ne Kahramanmaras / Turqi, dhe banues ne Turqi, Gazipasa Mah, 61 Sok. No 24/1 Dikili / Izmir, Shtetas turk, mbajtes i Pasaportes me nr. S21134422 dhe nr personal 19169110604 madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

**Qe ne vijim do te quhet Ortaku i Shoqerise “INTERMED HEALTHCARE” sh.p.k.**

Sot me date **06.10.2022**, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosi te themeloje Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

**Kreu I**  
**OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

**Neni 1**

**Objekti i shoqerise**

Shoqeria Tregtare “INTERMED HEALTHCARE” sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:

Sherbime mjeksore. Hapjen e kabineteve apo klinikave mjekesore. Sherbime ambulator, pediatrike etj. Shit blerje me pakice e shumice te aparaturave mjekesore, Konsulece. Trajnime mjekesore dhe turizem shendetsor.

**Neni 2**

**Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise**

Ortaku vendosi qe shoqerine ta emertoje “INTERMED HEALTHCARE” sh.p.k.

Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Njesia Administrative 10, Rruga Kavajes, Ndertesa 1, Hyrja 11, Ap. 2 Tirane

Shoqeria mund te krijojte qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjenci ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

**Neni 3**

**Forma Juridike**

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ORTAKEVE mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

**Kreu II**  
**TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

**Neni 4**

**Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve**

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

**Neni 5**

**Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

**Kreu III**  
**KAPITALI THEMELTAR**

**Neni 6**

**Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar eshte **100.000 (njqind mije) Leke**. 1 (nje) kuote gjithsej.

**Ortaket e shoqerise jane:**

1. **Cem Bagdatli**, zoterues i 1(nje) kuote me vlere 100.000 leke, qe perfaqeson **100% (njqind %)** kapitalin themeltar të shoqërisë;

**Kreu IV**  
**PERSONALITETI JURIDIK**


**Neni 7**

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e regjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit ne Tirane, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

**Kreu V**  
**ADMINISTRIMI**

**Neni 8**

Shoqeria do te administrohet nga administratori **Cem Bagdatli** i cili perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese)** vjecare dhe me te drejte rizgjedhje.  
Administratori mund t'i delegoje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.



**Kreu VI**  
**DISPOZITA TE TJERA**

**Neni 9**

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut te saj, ta ndaje si dividend apo ta shtoje ne kapitalin e shoqerise.  
Ky Akt shtypet dhe nenshkruhet ne 2 (dy) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore.  
Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

**ORTAKU THEMELUES**

**CEM BAGDATLI**

Cem Bagdatli  
